

Publikimi i ballinës së revistës Charlie Hebdo me karikaturën e Profetit Muhamed është "veprim idiot që kërkon veprim ligjor", tha ish-ministri i Kulturës së Arabisë Saudite dhe kryetari i Organizatës për Kooperim Islamik, Iyad Madani.

"Po shqyrtojmë ligjet evropiane dhe franceze, si dhe procedurat ligjore, në mënyrë që të bëjmë akuzë kundër revistës", tha Madani, transmeton Telegrafi.

Në llogarinë e tij personale në Twitter, Madani shtoi se këto karikatura kanë lënduar ndjenjat e myslimanëve në të gjithë botën.

"Liria e fjalës nuk duhet të bëhet fjalë e urrejtjes dhe nuk duhet të ofendojë të tjerët. Asnjë person i arsyeshëm, pavarësisht nga doktrina, fesë apo besimit, nuk do të pranojë që bindjet e tij të tallen", tha ai.

????? ??? ??????? ????????? "?????? ??????" ?????? ????????? ??????? ?????? ???????
?????????? ?????? ??????? ?????? ?????????? ?????????? ??????????.

— Iyad Amin Madani (@IyadMadani) [January 16, 2015](#)